



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr. 140/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, në seancën e panelit të mbajtur me 07.10.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Konstatohet e tërhequr ankesa** Anr. 140/2013 e datës 03.10.2013 e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj.

### **Arsyetim**

PZAP, ka pranuar një kërkesë për tërheqje të ankesës Anr. 140, me datë 06.10.2013, të LVV-së me të cilën pala ankuese kërkon tërheqjen e ankesës të parashtruar në PZAP me datë 03.10.2013, kundër subjektit politik AKR, dega Ferizaj, me arsyetimin se subjekti në fjalë ka kërkuar ndjesë për një akt të tillë, nëse kjo vepër është kryer nga anëtarët e tyre.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës Anr. 140/2013, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos ta shqyrtoj ankesën në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LVP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr. 140/2013 më datën 07.10.2013.

